



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/200  
Datë: 18.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/24, të datës 14 gusht 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/24, i datës 14 gusht 2020 si në vijim:

1.1. Pika 3. e Vendimit Nr. 05/24, i datës 14 gusht 2020, zëvendësohet me këtë tekst:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Zëvendëskryeministri i parë;
3. Ministrija e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
4. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve;
5. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
6. Ministrija e Ekonomisë;
7. Ministrija e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
8. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Ministrija e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
10. Ministrija e Drejtësisë;
11. Ministri i Shëndetësisë;
12. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
13. Ministri i Zhvillimit Rajonal;
14. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës;
15. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
16. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës;
17. Përfaqësuesi i Agjencisë përkatëse për Investime dhe Ndërmarrje në Kosovë;
18. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Kosovës;
19. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë;
20. Drejtorja Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare;
21. Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
22. Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
23. Drejtori Ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës;
24. Drejtori Ekzekutiv i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë;
25. Drejtorja Ekzekutive e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës G7;
26. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit;
27. Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Përpunimit të Frutave dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo);

28. Drejtorja Ekzekutive e Asociacionit të Kosovës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK);
29. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës (KIMERK).
30. Drejtorja Ekzekutive e Kllasterit të Ndërtimeve të Parafabrikuara të Kosovës.

- 1.2. Pika 4. e Vendimit zëvendësohet me këtë tekst: “Kryesuesi i Këshillit apo Sekretariati mund të ftojë edhe pjesëmarrës të tjerë në mbledhjet e Këshillit, të cilët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote.”
- 1.3. Pika 6. e Vendimit Zëvendësohet me këtë tekst: “Obligohet Sekretariati i Këshillit t’i përgatisë Rregullat dhe Procedurat e Punës së Këshillit, të cilat miratohen nga Këshilli.”

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë